



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

Shtojca 12.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

(Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 966/2026, datë 12.08.2026, dhe Vendimit nr. 991/2026, datë 18.08.2026, me të cilët është vendosur mospranimi i ankesave të operatorëve ekonomikë “Biotek” sh.p.k. dhe “Besim Kamberi” PF, si dhe lejimi i Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit)

Data: 20.08.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE) Skyline SC me NIPT: M51624039U, Adresa: Tirane Rruga Tulla 3, Zona Kadastrale 8320, Nr.pasurie 3/1431/ND, Njesia Bashkiake nr.111001.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) PO ☐ JO X

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Blerje/ Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur e Thjeshtuar

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-81198-04-07-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës: Blerje materiale për pastrim ambienti

Fondi limit: 3 224 810 (Tre milion e dyqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 30 (tridhjetë) dite.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **17.06.2026**

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **Buletini Nr. 40 datë 22 Qershor 2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Skyline SC me NIPT M51624039U

Vlera: 2 790 000 (Dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Biotek me NIPT L82203011N

Vlera: 2 418 607,5 (Dy milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatë presje pesë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. MIA Group Albania me NIPT M51310002C

Vlera: 2 796 200 (Dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. DELIA IMPEX me NIPT K57123001R

Vlera: 0 (Zero) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

5. EURO MEGA 2010 me NIPT K91624505A

Vlera: 2 418 608,8 (Dy milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetë presje tetë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. KEJ Group me NIPT M41707006H

Vlera: 2 420 200 (Dy milion e katërqind e njëzet mijë e dyqind) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. BESIM KAMBERI me NIPT L42103023G

Vlera: 2 217 080 (Dy milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Biotek me NIPT L82203011N

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të parimit të transparencës, barazisë në trajtim dhe detyrimit për zbatim strikt të kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, ka kryer verifikimin vetëm mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik, pa qenë e mundur të konsiderohen deklarime apo pretendime të paprovuara dokumentarisht. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka provuar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

1. Mospërmbushja e pikës 2.3.2 të DST-së

Për produktin “Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10–12%)”, operatori ekonomik duhet të paraqiste Raport Analize nga ISHP.

Nga verifikimi rezulton se dokumenti i paraqitur:

- nuk është lëshuar në emër të operatorit ekonomik ofertues;
- nuk lidhet me produktin konkret objekt prokurimi;
- i referohet një subjekti tjetër ekonomik.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk krijon gjurmueshmëri dhe provueshmëri të vlefshme për përmbushjen e kërkesës së DST-së.

2. Mospërmbushja e pikës 2.4.1 të DST-së

a) Pluhur larës lavatriçe

Skeda teknike nuk përmban të dhëna të plota dhe të verifikueshme mbi përbërjen e kërkuar të lëndëve tensioaktive sipas DST-së, duke mos mundësuar verifikimin objektiv të përputhshmërisë me specifikimet teknike.

b) Solucion larës WC dezinfektues

Megjithëse nga dokumentacioni rezulton përputhje me disa parametra kimikë të kërkuar në DST, nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme përmbushja e kërkesës për ambalazh me mekanizëm të posaçëm për pastrim të thellë të anëve të WC-së.

c) Solucion për zhbllokim lavamani

DST kërkon produkt në trajtë pluhuri, të ambalazhuar në qese plastike ose kuti kartoni.

Nga dokumentacioni teknik rezulton se produkti i ofertuar është në trajtë likuide dhe i ambalazhuar në shishe plastike 5L.

Kjo mospërputhje përbën devijim të drejtpërdrejtë dhe thelbësor nga specifikimet teknike të DST-së.

d) Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10–12%)

Megjithëse dokumentacioni teknik pasqyron disa nga parametrat kryesorë kimikë të kërkuar në DST, nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme:

- ambalazhimi në bidona plastikë rezistentë ndaj efektit të klorit;
- etiketimi me titullin e klorit aktiv sipas DST-së.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka përmbushur në mënyrë të plotë kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Mospërputhjet dhe mungesat e konstatuara përbëjnë devijime thelbësore nga kërkesat e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285/2021, oferta konsiderohet e papranueshme dhe operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. MIA Group Albania me NIPT M51310002C

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të parimit të transparencës, barazisë në trajtim dhe detyrimit për zbatim strikt të kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, ka kryer verifikimin vetëm mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik, pa qenë e mundur të konsiderohen deklaratime apo pretendime të paprovuara dokumentarisht. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka provuar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

1. Mospërmbushja e pikës 2.3.2 të DST-së

Për produktin “Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10–12%)”, operatori ekonomik duhet të paraqiste Raport Analize nga ISHP.

Nga verifikimi rezulton se dokumenti i paraqitur:

- nuk është lëshuar në emër të operatorit ekonomik ofertues;

- nuk lidhet me produktin konkret objekt prokurimi;
- i referohet një subjekti tjetër ekonomik.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk krijon gjurmueshmëri dhe provueshmëri të vlefshme për përmbushjen e kërkesës së DST-së.

2. Mospërmbushja e pikës 2.4.1 të DST-së

a) Pluhur larës lavatriçe

Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim prodhuesi për produktin, por nuk ka paraqitur skedë teknike.

Për rrjedhojë, mungon dokumentacioni teknik i nevojshëm për verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produktit me specifikimet teknike të DST-së.

d) Solucion larës WC dezinfektues

Megjithëse nga dokumentacioni rezulton përputhje me disa parametra kimikë të kërkuar në DST, nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme përmbushja e kërkesës për ambalazh me mekanizëm të posaçëm për pastrim të thellë të anëve të WC-së.

e) Solucion për zhblllokim lavamani

DST kërkon produkt në trajtë pluhuri, të ambalazhuar në qese plastike ose kuti kartoni. Nga dokumentacioni teknik rezulton se produkti i ofertuar është në trajtë likuide dhe i ambalazhuar në shishe plastike 5L.

Kjo mospërputhje përbën devijim të drejtpërdrejtë dhe thelbësor nga specifikimet teknike të DST-së.

f) Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10–12%)

Megjithëse dokumentacioni teknik pasqyron disa nga parametrat kryesorë kimikë të kërkuar në DST, nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme:

- ambalazhimi në bidona plastikë rezistentë ndaj efektit të klorit;
- etiketimi me titullin e klorit aktiv sipas DST-së.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka përmbushur në mënyrë të plotë kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Mospërputhjet dhe mungesat e konstatuara përbëjnë devijime thelbësore nga kërkesat e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285/2021, oferta konsiderohet e papranueshme dhe operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. DELIA IMPEX me NIPT K57123001R

Për arsyet e mëposhtme:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), në përputhje me kërkesat e DST-së.

Për rrjedhojë, mungon dokumentacioni teknik dhe provues mbi përmbushjen e kritereve të

kualifikimit dhe specifikimeve teknike, duke e bërë të pamundur verifikimin objektiv të përputhshmërisë së ofertës me kërkesat e procedurës së prokurimit.

Në zbatim të nenit 36 dhe nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 82 të VKM nr. 285/2021, mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë, të saktë dhe të mjaftueshëm teknik e provues për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Në këto kushte, oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme dhe e përputhshme me kushtet e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285/2021, operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. EURO MEGA 2010 me NIPT K91624505A

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të parimit të transparencës, barazisë në trajtim dhe detyrimit për zbatim strikt të kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, ka kryer verifikimin vetëm mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik, pa qenë e mundur të konsiderohen deklarime apo pretendime të paprovuara dokumentarisht. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka provuar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme përputhshmërinë e produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të DST-së.

1. Mospërmbushja e pikës 2.3.2 të DST-së

Referuar kërkesës së DST-së për produktin “Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10–12%)”, operatori ekonomik duhet të paraqiste Raport Analize nga ISHP në përputhje me parametrat teknikë të kërkuar.

Nga raporti i analizës i paraqitur rezulton se përmbajtja e klorit aktiv është 13.829%, ndërkohë që DST kërkon intervalin 10–12%.

Kjo mospërputhje numerike përbën devijim thelbësor nga specifikimet teknike të DST-së.

2. Mospërmbushja e pikës 2.4.1 të DST-së

a) Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë

Nga dokumentacioni teknik rezulton se:

- lëndët tensioaktive nuk janë të strukturuar sipas kërkesës së DST-së;
- nuk evidentohet në mënyrë të plotë përbërja e kërkuar për sapun, kripra fosfori dhe elementë zbardhues me bazë oksigjeni.

b) Solucion larës enësh lëng

Nga dokumentacioni teknik rezulton se:

- lëndët tensioaktive deklarohen 2–4%, në kundërshtim me kërkesën 15–20%;

c) Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10–12%)

Nga dokumentacioni teknik rezulton se:

- klori aktiv 13.829% tejkalon kufirin e kërkuar 10–12%;

- nuk provohet në mënyrë të verifikueshme alkaliniteti $\leq 5\%$;
- nuk dokumentohet mungesa e lëndëve të ngurta;
- nuk evidentohet ambalazhimi në bidona plastikë rezistentë ndaj klorit.

d) Acid muriatik

Nga dokumentacioni teknik rezulton se:

- përmbajtja e HCl 15–25% nuk përputhet me kërkesën 21%;
- densiteti 1.06–1.1 g/cm³ rezulton jashtë intervalit të kërkuar 1.1–1.4 g/cm³.

Këto mospërputhje përbëjnë devijime thelbësore nga specifikimet teknike të DST-së.

e) Solucion për zhblllokim lavamani

Produkti i ofertuar rezulton në formë lëngu, ndërkohë që DST kërkon produkt në trajtë pluhuri.

Gjithashtu, nga dokumentacioni teknik nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme:

- mungesa e shkumës;
- mosdëmtimi i tubave plastikë;
- ambalazhimi sipas kërkesës së DST-së.

f) Solucion për zhblllokim banjo (WC/Pileta)

Nga dokumentacioni teknik nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme:

- mosnevoja për hollim;
- shmangia e spërkatjes;
- aroma sipas specifikimit teknik;
- karakteristikat funksionale të kërkuara.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka provuar përputhshmërinë e plotë të produkteve me specifikimet teknike të kërkuara në DST. Mospërputhjet e konstatuara përbëjnë devijime thelbësore nga kushtet e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 36 dhe nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285/2021, oferta konsiderohet e papranueshme dhe operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. KEJ Group me NIPT M41707006H

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të parimit të transparencës, barazisë në trajtim dhe detyrimit për zbatim strikt të kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, ka kryer verifikimin vetëm mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik, pa qenë e mundur të konsiderohen deklarime apo pretendime të paprovuara dokumentarisht. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se dokumentacioni teknik i paraqitur nuk provon në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

1. Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë

Nga shqyrtimi i skedës teknike rezulton se nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme përmbushja e kërkesës së DST-së lidhur me aftësinë shkumuese më të vogël se

5 cm.

Skeda teknike e paraqitur nuk përmban të dhëna të mjaftueshme teknike dhe të verifikueshme mbi këtë parametër, duke e bërë të pamundur verifikimin objektiv të përputhshmërisë me DST.

2. Solucion larës enësh lëng

DST ka kërkuar shprehimisht deklarin dhe provueshmërinë dokumentare të këtij parametri teknik, ndërsa dokumentacioni i paraqitur nuk përmban të dhëna laboratorike apo deklarin teknik të verifikueshëm mbi këtë element për analizën spektrale në etiketë.

Për rrjedhojë, mungon dokumentacioni teknik i mjaftueshëm për verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produktit me specifikimet teknike.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion teknik të plotë dhe të mjaftueshëm për të provuar përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Mospërputhjet dhe mungesat e konstatuara përbëjnë devijime thelbësore nga kërkesat e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285/2021, oferta konsiderohet e papranueshme dhe operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. BESIM KAMBERI me NIPT L42103023G

Për arsytet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të parimit të transparencës, barazisë në trajtim dhe detyrimit për zbatim strikt të kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, ka kryer verifikimin vetëm mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik, pa qenë e mundur të konsiderohen deklarime apo pretendime të paprovuara dokumentarisht. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka provuar në mënyrë të plotë, të saktë dhe të verifikueshme përputhshmërinë e produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në zbatim të nenit 36 dhe nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, specifikimet teknike janë detyruese dhe barra për provimin e përputhshmërisë me to i takon operatorit ekonomik nëpërmjet dokumentacionit teknik dhe provues të paraqitur në procedurën e prokurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultuan mospërputhjet si më poshtë:

1. Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë

Nga dokumentacioni teknik i paraqitur rezulton se skeda teknike nuk përmban të dhëna të mjaftueshme teknike dhe funksionale lidhur me:

- dendësinë;
- pH;
- tretshmërinë;
- lagështinë;

- përbërjen e lëndëve tensioaktive;
- aftësinë shkumuese;
- praninë e enzimave;
- ambalazhimin;
- identifikimin me markë tregtare dhe barkod prodhuesi.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk mundëson verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produktit me specifikimet teknike të DST-së.

2. Solucion larës xhamash

Nga dokumentacioni teknik i paraqitur nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme përmbushja e kërkesës së DST-së për:

- ambalazhim në shishe plastike me mekanizëm sprucimi;
- barkod prodhuesi.

4. Acid muriatik

Nga verifikimi i dokumentacionit teknik rezulton se parametrat e deklaruar për produktin nuk përputhen me specifikimet teknike të DST-së lidhur me përmbajtjen e acidit klorhidrik (HCl) dhe parametrat fizikë të kërkuar.

Kjo mospërputhje përbën devijim thelbësor nga specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

5. Solucion për zhbllokim lavamani

Nga dokumentacioni teknik i paraqitur nuk evidentohet dhe nuk provohet në mënyrë të verifikueshme përputhshmëria me kërkesat e DST-së lidhur me:

- formën fizike të produktit;
- mungesën e shkumës;
- mbrojtjen e tubave plastikë;
- ambalazhimin;

6. Solucion për zhbllokim banjo (WC/Pileta)

Nga dokumentacioni teknik i paraqitur Skeda teknike nuk përmban të dhëna të mjaftueshme teknike dhe funksionale lidhur me:

- identifikimin e produktit;
- karakteristikat fizike;
- përshkrimin teknik të kërkuar në DST.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion teknik të plotë dhe të mjaftueshëm për të provuar përputhshmërinë e produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Mospërputhjet dhe mungesat e konstatuara përbëjnë devijime thelbësore nga kërkesat e DST-së dhe nuk krijojnë bazë për konsiderimin e ofertës si të përgjegjshme dhe të përputhshme me kushtet e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285/2021, oferta konsiderohet e papranueshme dhe operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: Skyline SC me NIPT: M51624039U, Adresa: Tirane Rruga Tulla 3, Zona Kadastrale 8320, Nr.pasurie 3/1431/ND, Njesia Bashkiake nr.111001 se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2 790 000 (Dy miolion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH dhe 3 348 000 (Tre milion e treqind e dyzet e tetë mijë) Lekë me TVSH është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe duke qenë se nuk ka ofertues tjetër të kualifikuar në klasifikimin përfundimtar, në rast të mosparaqitjes së sigurimit të kontratës ose të refuzimit për nënshkrimin e saj nga ofertuesi fitues, Autoriteti Kontraktor do të vijojë me anulimin e procedurës së prokurimit, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO X JO ☐

1. Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 966/2026, datë 12.08.2026, me të cilin është vendosur mospranimi i ankesës nr. A/2026/6868 të operatorit ekonomik “Biotek” sh.p.k.
2. Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 991/2026, datë 18.08.2026, me nr. 2035/6 prot., me të cilin është vendosur mospranimi i ankesës nr. A/2026/6878 të operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF dhe lejimi i Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.